

## **Politika e privatësisë**

Të nderuar përdorues të faqes tonë të internetit,

Ju faleminderit për interesin e shfaqur. Mbrojtja e të dhënave paraqet prioritet për menaxhmentin e (ProCredit Bank, rr. Manapo nr. 7, e-mail për kontakt: [info@procreditbank.com.mk](mailto:info@procreditbank.com.mk), numër për kontakt 02/2 446 000) ("ProCredit Banka"). Është mundësuar përdorimi i faqeve të internetit të ProCredit Bankës pa dhënien e të dhënave personale, mirëpo nëse përdoruesi dëshiron të përdor shërbime të veçanta përmes faqes sonë të internetit, përpunimi i të dhënave personale mund të jetë i domosdoshëm. Në atë rast edhe nëse nuk ekziston bazë ligjore për përpunimin e tillë, ne zakonisht marrim pëlqimin nga përdoruesi.

### **1. „Cookies“ (biskota)**

Faqet e internetit të ProCredit Bankës përdorin "cookies" (biskota). Biskotat janë skedarë tekstuale të ruajtura në sistemin kompjuterik përmes shfletuesit të internetit.

Numër i madh i faqeve të internetit dhe serverëve përdorin biskota. Numër i madh i biskotave përmbajnë të ashtuquajturën "identifikim i biskotës" që paraqet identifikuesin unik të biskotës. Përbëhet nga një sërë karakterësh përmes të cilëve faqet e internetit dhe serverët mund të përcaktojnë shfletuesin konkret të internetit në të cilin është ruajtur biskota. Kjo mundëson që faqet e vizituar të internetit dhe serverët të dallojnë shfletuesin e përdoruesit nga shfletuesit e tjerët të internetit të cilët përmbajnë biskota të tjera. Shfletuesi konkret i internetit mund të dallohet dhe identifikohet me anë të shfrytëzimit të identifikimit unik të biskotës.

Përmes përdorimit të biskotave, ProCredit Banka mund të ju sigurojë përdoruesve të kësaj faqe të internetit shërbime me qasje më të mirë për përdoruesin të cilat nuk do të ishin të mundshme pa vendosjen e biskotave.

Me ndihmën e biskotës, informatat dhe ofertat në faqen tonë të internetit mund të bëhen edhe më optimale për përdoruesin. Ashtu siç përmendëm më parë, biskotat na mundësojnë që të dallojmë përdoruesit e faqes tonë të internetit, me qëllim që ata më lehtë të përdorin faqen tonë të internetit. Për shembull, përdoruesi i faqes së internetit i cili përdor biskota nuk ka nevojë që të shkruajë të dhënat sa herë që do të hyjë në faqen e internetit, sepse këtë e ndërmer faqja e internetit, ndërsa biskota është ruajtur në sistemin kompjuterik të përdoruesit.

Përdoruesi mundet në çdo kohë të parandalojë vendosjen e biskotave përmes faqes tonë të internetit me ndihmë të parametrave përkatës të shfletuesit të internetit që përdoret, dhe me atë në mënyrë permanente të refuzojë vendosjen e biskotave. Poashtu, biskotat që më janë vendosur, mundin në çdo kohë të fshihen përmes shfletuesit të internetit ose programeve të tjera të softuerit. Kjo është e mundur të gjithë shfletuesit e popullarizuar të internetit. Nëse përdoruesi e deaktivizon vendosjen e biskotave në shfletuesin e internetit që përdor, mundet që disa nga funksionet e faqes tonë të internetit të bëhen të papërdorshme.

### **2. Mbledhja e të dhënave dhe informatave të përgjithshme**

Faqja e internetit e ProCredit Bankës mbledh një sërë të dhënash dhe informata të përgjithshme kur përdoruesi ose sistemi automatik e kërkon faqen e internetit. Këto të dhëna dhe informata të përgjithshme ruhen në regjistrat e serverëve. Mund të mbledhen (1) lloje dhe versionet e shfletuesëve të cilët përdoren, (2) sistemi operativ të cilin sistemi për qasje e përdor, (3) faqja e internetit nga e cila sistemi ka qasje në faqen tonë të internetit (të ashtuquajturit rekomandues), (4) nën-faqe të internetit, (5) data dhe koha e qasjes në faqen e internetit, (6) adresa e protokollit të internetit (IP adresa), (7) ofruesi (provajderi) i

shërbimeve të internetit në sistemin për qasje dhe (8) të dhëna dhe informata të tjera të ngjajshme që mund të përdoren në rast të sulmeve mbi sistemet tona informative.

Gjatë përdorimit të këtyre të dhënave dhe informatave të përgjithshme, ProCredit Banka nuk nxjerr kurrfarë konkluzione për përdoruesin. Në vend të kësaj, këto informata janë të nevojshme (1) që në mënyrë të duhur të dorëzohet përmbajtja e faqes sonë të internetit, (2) të optimizohet përmbajtja e faqes sonë të internetit si dhe reklamimi i saj, (3) të sigurohet qëndrueshmëri afatgjate të sistemeve tona informatike dhe teknologjisë së internetit dhe (4) organeve përgjegjëse për zbatimin e ligjit të ju sigurohen informata të nevojshme për ndjekjen penale në rast të sulmit kibernetik. Për shkak të kësaj, ProCredit Banka statistikisht i analizon të dhënat dhe informatat e mbledhura në mënyrë anonime me qëllim të rritjes së mbrojtjes dhe sigurisë së të dhënave dhe sigurimin e nivelit optimal të të dhënave personale të cilat i përpunojmë. Të dhënat anonime në regjistrat e serverëve ruhen veçmas nga të gjitha të dhënat personale të siguruar nga përdoruesi.

### **3. Dispozita për mbrojtjen e të dhënave për zbatimin dhe përdorimin e Google Analytics (me funksion të anonimizimit)**

Në këtë faqe të internetit, ProCredit Banka e integron komponentën e Google Analytics (me funksion të anonimizuesit). Google Analytics është vegël për analitikë të internetit. Analitika e internetit paraqet mbledhje dhe analizë të të dhënave për sjelljen e vizitorëve të faqeve të internetit. Vegla e analizës së internetit, përveç tjerash, mbledh të dhëna për faqen e internetit nga e cila vjen personi (i ashtuquajtur i rekomandues), cilat nën-faqe kanë qenë të vizituara ose sa shpesh dhe sa gjatë ka qenë e rishikuar nën-faqja. Analizat e internetit kryesisht përdoren për optimizim të faqeve të internetit dhe për zbatimin e analizës ekonomike të reklamimit përmes internetit.

Operator i komponentës Google Analytics është Google Inc., 1600 Amphitheatre Pkwy, Mountain View, CA 94043-1351, SHBA.

Për analitikën e internetit përmes Google Analytics, ProCredit Banka e përdor aplikacionin "\_gat. \_anonymizep". Me këtë aplikacion, IP adresa e lidhjes së internetit të përdoruesit është e shkurtuar nga Google dhe është bërë anonime gjatë qasjes në faqet tona të internetit.

Komponenta Google Analytics është dizajnuar për analizën e trafikut të internetit në faqen tonë të internetit. Google i përdor të dhënat dhe informatat e mbledhura, ndër të tjera, për të vlerësuar përdorimin e faqes sonë të internetit dhe të sigurojë raporte online të cilat do të tregojnë aktivitetet e faqeve tona të internetit, si dhe të sigurojë shërbime të tjera në lidhje me shfrytëzimin e përdorimit të faqes sonë të internetit për ne.

Google Analytics paraqet biskotë të sistemit informativ të përdoruesit. Përkufizimi i biskotave është shpjeguar më sipër. Me vendosjen e biskotës, Google mund të analizojë përdorimin e faqes sonë të internetit. Me çdo kërkim të një nga faqet e veçanta të kësaj faqeje të internetit, shfletuesi i internetit i sistemit informativ të përdoruesit, automatikisht do të dorëzojë të dhënat përmes komponentës Google Analytics për qëllimet e reklamimit online dhe shlyerjen e tarifave për Google, sipas nevojës. Gjatë kësaj procedure teknike, Google fiton qasje në informatat, siç janë IP (e shkurtuar) adresa e përdoruesit e cila i shërben Google, ndër të tjera, për të zbuluar origjinën (vendin, rajonin, qytetin) e vizituesve dhe të klikimeve.

Biskota përdoret për ruajtjen e informatave siç janë koha e qasjes, vendi nga i cili është bërë qasja dhe frekuenca e vizitave të faqes sonë të internetit nga përdoruesi. Me çdo vizitë të faqes sonë të internetit, këto të dhëna, përfshirë edhe IP (të shkurtuar) adresën të qasjes së internetit të përdoruesit, do të transferohen në Google në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këto të dhëna i ruan Google në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Google mund të transferojë tek palë të treta ato të dhëna të cilat janë mbledhur përmes procedurës.

Siç u përmend më parë, përdoruesi mundet në çdo kohë të parandalojë vendosjen e biskotave përmes faqes sonë të internetit me rregullim adekuat të shfletuesit të internetit të cilin e përdor, dhe me atë në mënyrë përhershme të refuzojë vendosjen e biskotave. Me rregullimin e tillë të shfletuesit të internetit, edhe vegla Google Analytics nuk mund të vendos biskotë në sistemin informatik të përdoruesit. Poashtu, biskotat të cilat Google Analytics më i përdor, mundet në çdo kohë të fshihen përmes shfletuesit të internetit ose përmes programeve të tjera softuerike.

Përveç kësaj, përdoruesi ka mundësinë të kundërshtojë dhe të parandalojë mbledhjen e të dhënave të cilat janë gjeneruar nga Google Analytics, në lidhje me përdorimin e faqes sonë të internetit, si dhe përpunimin e atyre informatave nga Google. Për këtë qëllim, subjekti mund të shkarkojë shtesat e shfletuesit nga URL <https://tools.google.com/dlpage/gaoptout> dhe t'i instalojë ato. këto shtesa (plug-ins) të shfletuesit i tregojnë Google Analytics përmes JavaScript se të gjitha të dhënat dhe informatat e vizitave të faqeve të internetit nuk mund të transferohen në Google Analytics. Instalimi i shtesave të shfletuesit konsiderohet si një ankesë nga Google. Nëse sistemi informativ i përdoruesit fshihet më vonë, formatohet ose përsëri instalohet, atëherë përdoruesi duhet të riinstalojë shtesat e shfletuesit për të pamundësuar Google Analytics. Nëse shtesat e shfletuesit kanë qenë të çinstaluar nga përdoruesi ose person tjetër kompetent, ose kanë qenë të pamundësuar, mund të bëhet riinstalim ose riaktivizim i shtesave të shfletuesit.

Informatat shtesë, si dhe dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave mund të ndërmerren nga: <https://www.google.com/intl/en/policies/privacy/> dhe <http://www.google.com/analytics/terms/us.html>. Shpjegimi shtesë për Google Analytics mund të gjendet edhe në këtë link: <https://www.google.com/analytics/>.

#### **4. Regjistrimi faqes sonë të internetit**

Përdoruesi ka mundësinë që të regjistrohet në faqen e internetit të ProCredit Bankës duke cekur të dhënat personale. Me maskën e përshtatshme hyrëse e cila përdoret për regjistrim, përcaktohen se cilat të dhëna personale transferohen deri te ne. Të dhënat personale të regjistruara nga përdoruesi grumbullohen dhe ruhen ekskluzivisht për përdorim të brendshëm nga ProCredit Banka dhe për qëllimet e veta. ProCredit Banka mund të kërkojë transfer të dhënave në një ose më shumë procesorë (p.sh. një pako shërbimesh) që poashtu përdor të dhëna personale për përdorim të brendshëm të ProCredit Bankës.

Me regjistrimin e faqes së internetit të Procredit Bankës, poashtu ruhet edhe IP adresa e cila është e dhënë nga ofruesi i shërbimeve të internetit për përdorim nga përdoruesi, si dhe data dhe koha e regjistrimit. Ruajtja e këtyre të dhënave bëhet me qëllim të parandalimit të keqpërdorimit të shërbimeve tona dhe nëse është e domosdoshme, të mundësohet hetim për kundërvajtjet e bëra. Ruajtja e këtyre të dhënave është e domosdoshme për mbrojtjen e ProCredit Bankës. Këto të dhëna nuk transferohen deri te palë të treta përveç nëse nuk ekziston detyrimi ligjor për transferimin e të dhënave ose nëse transferimi shërben për ndjekje penale.

Regjistrimi i përdoruesit, me dhënie vullnetare të të dhënave personale ka për qëllim të mundëson ProCredit Bankën të ju mundësojë shfrytëzuesve përmbajtje ose shërbime të cilat janë të dedikuara vetëm për përdorues të regjistruar për shkak të natyrës së subjektit për të cilin bëhet fjalë. Personat e regjistruar mundet në çdo kohë që lirshëm të ndryshojnë të dhënat personale të shënuara gjatë regjistrimit ose tërësisht t'i fshijnë nga të dhënat e ProCredit Bankës.

ProCredit Banka do të sigurojë në çdo kohë informata sipas kërkesës së çdo përdoruesi për atë se cilat të dhëna personale të tij janë ruajtur. Poashtu, ProCredit Banka do të bën edhe korigjimin ose fshirjen e të dhënave personale sipas kërkesës ose indikacioniot të përdoruesit, nëse nuk ka detyrim ligjor për ruajtje. Në lidhje me këtë, përdoruesi mund të kontaktojë: Qendrën për Kontakt 02/ 2 446 000 ose në e-mail: [info@procreditbank.com.mk](mailto:info@procreditbank.com.mk) .

#### **5. Mundësia për kontakt përmes faqes së internetit**

Faqja e internetit e ProCredit Bankës përmban informata të cilat mundësojnë kontakt të shpejtë elektronik me ndërrmarjen tonë, si dhe komunikim të drejtëpërdrejtë me ne, që poashtu përfshin edhe adresën e të ashtuquajturës postë elektronike (e-mail adresën). Nëse përdoruesi kontakton me ProCredit Bankën përmes postës elektronike ose përmes një formulari për kontakt, të dhënat personale të cilat ai i transferon, ruhen automatikisht. Të dhënat e tilla personale të cilat përdoruesi në mënyrë vullnetare i transferon te ProCredit Banka, ruhen për përpunim ose kontakt me përdoruesin. Ato të dhëna nuk transferohen tek palë të treta.